

**VENDIM**  
**Nr. 331, datë 6.6.2018**

**PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË STATUSIT, NGA TOKË BUJQËSORE NË TOKË TRUALL, PËR NDËRTIMIN E NJË FABRIKE TË PRODHIMIT TË PANELEVE SANDUIÇE (KAPANON 1 KAT DHE ZYRA 2 KATE), STRUKTURË ME FUNKSION PRODHUES, INDUSTRIAL, PËRFSHIRË EDHE ATO ME MATERIAL POROSITËSI NGA SHOQËRIA “EMANTE” SHPK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 11/1, të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001, “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e ndryshimit të statusit, nga tokë bujqësore në tokë truall, të sipërfaqes prej 19 889 (nëntëmbëdhjetë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e nëntë) m<sup>2</sup>, sipas lidhjes 1, bashkëlidhur këtij vendimi, për ndërtimin e një fabrike të prodhimit të paneleve sanduiçe (kapanon 1 kat dhe zyra 2 kate), strukturë me funksion prodhues, industrial, përfshirë edhe ato me material porositësi nga shoqëria “Emante” sh.p.k.
2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës të qarkut Durrës të pasqyrojë në dokumentacionin kadastral përkatës ndryshimet e kategorisë së resursit, nga tokë bujqësore në tokë truall, për sipërfaqen prej 19 889 (nëntëmbëdhjetë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e nëntë) m<sup>2</sup>, sipas pikës 1 të këtij vendimi.
3. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Qarkut Durrës, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës dhe Bashkia Durrës për zbatimin e këtij vendimi.  
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI**  
**Senida Mesi**

TOKË ARË (KATEGORIA V)

| Bashkia       | Njësia administrative | Fshati      | Zona kadastrale | Numri i pasurisë | Pronari                   | Lloji i pasurisë | Kategoria e tokës bujqësore | Truall i kërkuar (m²) |
|---------------|-----------------------|-------------|-----------------|------------------|---------------------------|------------------|-----------------------------|-----------------------|
| Durrës        | Katund i Ri           | Bisht-Kamzë | 1198            | 64/16            | Shoqëria “Emante” sh.p.k. | Arë              | V                           | 19889                 |
| <b>TOTALI</b> |                       |             |                 |                  |                           |                  |                             | <b>19889</b>          |